



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 52 prot.

Kamëz, më 19.042021

V E N D I M

Nr. 43, datë 19.04.2021

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORET SHOQËRORE PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.04.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim Projekt – Nr.37 Datë 12.04.2021 mbështetur në Ligjin 57. Datë 18.07.2019”Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar dhe VKM 597 dt., 04.09.2019 kreu 4 pika 3 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Dhe në VKB nr 158 datë 18.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit Mars , prej 57 familjeve që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është 386,240 (treqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e dyzetë) lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij projekt-vendimi paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

Nën/kryetar Këshilli
Ali Dauti